

VENDIM
Nr.537, datë 27.7.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “LASHKIZË 1” DHE “LASHKIZË 2” DHE
MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I
JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, shkronja “b”, e 23, pika 3 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Lashkizë 1” dhe “Lashkizë 2”, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Dhënie e bonusit prej 2 (dy) pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) që i jepet shoqërisë “Hidrotimb” sh.p.k., për dhënie me koncesion të këtyre hidrocentraleve.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Lashkizë 1” dhe “Lashkizë 2”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha